



ARKEP

AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS
REGULATORNI AUTORITETE ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DHËNIEN DHE SHFRYTËZIMIN E RADIO FREKUENCAVE NË BREZET 3.4 - 3.8 GHz

1) Ndërmarrësi (Operatori i Autorizuar) gjatë ofrimit të shërbimeve BWA & FWA, duhet të operojë dhe tu përmbahet kushteve të përcaktuara sipas;

I. Kornizës Ligjore të Republikës së Kosovës;

- Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109;
- Planit Kombëtar dhe Tabelës së Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Radio Frekuencave;
- Planit të Përdorimit të Radio frekuencave; dhe
- Legjislacionit sekondar të miratuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

II. Kornizës Rregullatore të CEPT;

Korniza e aplikueshme rregullatore për implementimin/shfrytëzimin e shërbimeve BWA, në brezin 3400 - 3800 MHz, e përcaktuar përmes dokumenteve të mëposhtme;

- Rekomandimit ECC/REC (04)05 (Shkurt, 2006);
- Vendimit ECC/DEC (07)02 (Mars);
- Vendimit ECC/DEC (11)06;
- Vendimit të Komisionit Evropian 2008/411/EC (21 May 2008).

2) Koordinimi dhe harmonizimi i shfrytëzimit të radio frekuencave në zonat ndërkufitare;

- I. Në zonat ndërkufitare, i autorizuari duhet të sigurojë që operimi i radio paisjeve të jetë në pajtim me normat dhe koordinimet e arritura ndërkombëtare. I autorizuari do të njohtohet me kohë nga Autoriteti me obligimet që dalin nga marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale.
- II. Koordinimi ndërkombëtar ndërkufitar, i autorizuari duhet të sigurojë se radio pajisjet operojnë dhe i përshtaten parametrave teknik të përcaktuar me vendimet dhe Rekomandimet Evropiane (Vendimi ECC/DEC (07)02; Raportit ECC 76 *etj*), që kanë të bëjnë me harmonizimin e radio frekuencave te brezit frekuencor 3.6- 3.8 GHz në zonat kufitare të shërbimeve FWA/BWA.

I autorizuari duhet t'i harmonizojë parametrat teknik të radio pajisjeve për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet dhe parametrat e përkufizuar me marrëveshjet bilaterale apo multilaterale që Autoriteti apo organet kompetente do ti arrijnë me vendet tjera në/dhe lidhur me harmonizimin dhe koordinimin e shfrytëzimit të radio frekuencave në zonat kufitare sipas kushteve që parashihen me marrëveshje.

3) Transferimi;

Ky Autorizim nuk mund të transferohet pa pëlqimin paraprak të ARKEP. Transferimi i të drejtës së shfrytëzimit të radio-frekuencave dhe obligimeve që rrjedhin nga Autorizimi, mund të transferohet sipas procedurave të përcaktuara nga Autoriteti në përputhje dhe zbatim të dispozitave të neneve; 10 paragrafi 15); nenet 53 dhe 54 paragrafi 2.5), të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 dhe nenin 10 të Rregullores Nr. 22 për Dhënien dhe Shfrytëzimin e Radio Frekuencave.

4) Pagesa e rregullt vjetore;

I autorizuari duhet t'i paguajë Autoritetit pagesën e rregullt vjetore për përdorimin e radio frekuencave, në përputhje me kushtet e përcaktuara me rregulloret e mëposhtme;

- Rregullorja Nr. 17 për Pagesat për Shfrytëzimin e Radio Frekuencave.
- Rregullorja Nr. 22 për Dhënien dhe Shfrytëzimin e Radio frekuencave,

5) Modifikimi & pezullimi /Anulimi i të Drejtës së Shfrytëzimit të Radio Frekuencave;

Në përputhje me nenet 8 dhe 11 të Rregullores Nr. 22 për Dhënien dhe Shfrytëzimin e Radio Frekuencave, me kërkesë të ndërmarrësit/operatorit, ARKEP mban të drejtën e ndryshimit të kushteve për të shfrytëzuar radio frekuencat, pezullimin dhe/apo anulimin e të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave si dhe ndërrimin e parametrave teknik të radio frekuencave.

Parimi ligjor i neutralitetit teknologjik i aplikuar në/për teknologji dhe shërbime, i jep të autorizuarit të drejtën e shfrytëzimit të radio pajisjeve dhe shërbimeve, gjithmonë në përputhje me Ligjin për Komunikime Elektronike; Planin Kombëtar dhe Tabelën e Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Radio Frekuencave; Rregullores për Dhënien dhe Shfrytëzimin e Radio Frekuencave si dhe Vendimit të Komisionit Evropian 2008/411/EC, për brezin 3400 - 3800 MHz.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit
